

## **AKT THEMELIMI**

### **" Albanian Solution "**

#### **SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

Sot, me date 22/04/2023, ne Tirane, Z. Eridjon Haxhia , person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 22/01/1988, mbajtes i dokumentit te identifikimit me numer personal I80122086D, me zotesi te plote juridike per te vepruar nenshkruan kete akt themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " Albanian Solution " .

#### ***Neni 1***

##### ***Forma e shoqerise***

Ortaku themelon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e tyre eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te derdhur, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjeter.

#### ***Neni 2***

##### ***Emertimi i shoqerise***

Emertimi i shoqerise eshte " Albanian Solution "

#### ***Neni 3***

##### ***Baza juridike***

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e statutit dhe aktiti te themelimit.

#### ***Neni 4***

##### ***Objekti i veprimtarise***

4.1 Veprimtaria e shoqerise " Albanian Solution " do te kete per objekt:

4.2 Sherbime konsulence per shoqerite, konsulenca administrative, financiare dhe organizative. Sherbim konsulence ne fushen e sherbimeve tregtare: ne pergjithesi dhe mbi zhvillimin sipermarrieve. Sherbime outsourcing te personelit per aktivitete administrative, organizative dhe tregtare. Aktivitete te konsultimit dhe keshillimi ne marketing, publicitet, projektim, realizimin,



menaxhimin dhe vleresimin e projekteve inovative. Perpunimin e informacionit te çfaredo lloj natyre, te aksesueshem permes programeve te menaxhimit te informacionit si Microsoft Word, Excel, PowerPoint, Access, Adobe. Projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nepermjet shfrytezimit te te gjitha instrumenteve, perfshire marketingun telefonik dhe instrumenta te tjera te marketingut nepermjet internetit. Objekt i ketij aktiviteti do te jete çdo lloj aktiviteti i ngjashem qe do te konsiderohet i vlefshem nga vete politikat tregtare te shoqerise dhe qe nuk bien ndesh me legjislacionin ne fuqi qe udheheq fushen e marredhenieve te tregtise se lire ne territorin e Republikes se Shqiperise. Shoqeria ka te drejte te ushtroje çfaredo lloj veprimtarie tjeter te lejuar nga ligji dhe ne perputhje me rregullat ne fuqi.

4.3 Shoqeria, me vendim te administratorit, mund te lidhe marreveshje tregtare apo bashkepunimi me shoqeri apo sipermarrje te tjera, si dhe te kryeje cdo veprim tregtar qe konsiderohet i nevojshem me qellim arritjen e objektit te veprimtarise se saj.

4.4 Per te realizuar qellimet e saj, shoqeria mund te siguroje dhe perdore financime nga ortakët, nga vende te tjera, ose nga institucione financiare vendase ose te huaja.

4.5 Objekti i veprimtarise se shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te ortakut.

#### ***Neni 5***

#### ***Selia***

Shoqeria " Albanian Solution " e ka seline ne adresen: TIRANE, Kamez, Rruga Gramshi, Ndertesa nr 51, hyrja 1.

Ne kete adrese do te ushtrohet aktiviteti kryesor i shoqerise.

#### ***Neni 6***

#### ***Kohezgjatja***

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar.

## ***Neni 7***

### ***Kapitali i shoqerise***

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 (njqind) leke.

## ***Neni 8***

### ***Administrimi***

Administrator i shoqerise do te jete:

Z. Eridjon Haxhia , person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 22/01/1988, mbajtes i dokumentit te identifikimit me numer personal I80122086D

Afati i emerimit te administratorit do te jete per nje periudhe kohe pese vjecare nga 22/04/2023 deri ne 21/04/2028.

## ***Neni 9***

### ***Viti financiar***

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti kalendarik. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe do te mbyllet ne fund te vitit perkates.

## ***Neni 10***

### ***Te ardhurat neto***

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapital. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo viti ushtrimor, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas shlyerjes se detyrimeve tatimore dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne pasqyrat dhe raportet financiare tec do viti financiar, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise, ose mund te rrinvestohen si kapital i shoqerise.

***Neni 11***

***Juridiksioni***

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, kompetente per zgjidhjen e tyre jane gjykatat shqiptare.

Ky akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " Albanian Solution " eshte hartuar ne 5 kopje ne gjuhen shqipe dhe pasi lexohet, nenshkruhet nga ortaket themelues.

**ORTAK I SHOQERISE**

**" Albanian Solution "**

**Eridjon Haxhia**

*Eridjon Haxhia*  
*Eridjon*